



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 12, datë 14.10.2020

PËR

**MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KUKËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 8, DATË 08.02.2017,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**


Në mbështetje të neneve 7, 20, 25, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 2 dhe 10, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe të Vendimit Nr. 8, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kukës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës, të miratuar me Vendimin Nr. 8, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit, Shtojca I, Neni 83, “Pasaportat në nivel zone dhe njësie”, sipas Dokumentit të Korrigjimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës, bashkëlidhur këtij Vendimi.*
1. Ngarkohen Bashkia Kukës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
2. Ngarkohen Bashkia Kukës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

